



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1343/ 1 prot.,

Datë 27.05.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Florfarma*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me objekt Loti II “*Produkte detergjentë*” me Nr. REF-46199-04-25-2025, me fond limit: 978,102 (nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.05.2025 nga autoriteti kontraktor Qendra Komunitare Gonxhe Bojaxhi.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Florfarma*” SHPK me NIPT K21405001N me adresa: Rruga “Qazim Vathi”, Nr. 72, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Komunitare Gonxhe Bojaxhi.
Adresa: Rruga “Selaudin Bekteshi”, Tiranë.

Në datë 26.05.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është depozituar ankesa elektronike me numër A/2025/5335 dhe me nr. 1343/2025 Prot., date 26.05.2025 e operatorit ekonomik “*Florfarma*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me objekt Loti II “*Produkte detergjentë*” me Nr. REF-46199-04-25-2025, me fond limit: 978,102 (nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.05.2025 nga autoriteti kontraktor Qendra Komunitare Gonxhe Bojaxhi.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Florfarma*” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK:

- Nuk ka plotësuar kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe formulari i vetëdeklarimit është i paplotësuar ne te gjitha rubrikat e kerkuara.

Bazuar në nenin 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 26 pika 3 citon: Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. Operatori ekonomik nuk ka plotësuar asnjë prej rubrikave qe kerkohen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 27.05.2025

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri